

**VENDIM**  
**Nr.58, datë 28.1.2005**

**PËR FINANCIMIN E KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE TË TOKËS, QË DO TË  
ZHVILLOHET NË TIRANË, NË DATAT 13-18 MARS 2005**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 24 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Financimin me një fond prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, të Konferencës Ndërkombëtare të Tokës, që do të zhvillohet në Tiranë, në datat 13-18 mars 2005.

2. Ky fond të përballohet si më poshtë vijon:

a) 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit;

b) 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Mjedisit.

3. Fondet e mësipërme të xhirohen në një bankë të nivelit të dytë, në një llogari të veçantë të Institutit të Studimit të Tokave, për Konferencën Ndërkombëtare të Tokës.

4. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**